



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 16.12.2014

Nr. 0204-1667

PËR: **Mimoza Kusari Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës**
Luan Gola Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

LËNDA: Konfirmimi i ligjshmërisë së Vendimit 01 Nr. 011-51211 të datës 27.11.2014 për aprovimin e listës së propozuar për shqyrtim nga Komisioni për Emërtimin e Rrugëve të Komunës së Gjakovës, për emërtimin e zonave të qarkullimit publik (rrugëve, parqeve dhe shesheve) në Komunën e Gjakovës

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të Vendimit 01 NR. 011-51211 Dt. 27.11. 2014 miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendim 01 Nr. 011-51211 të datës 27.11.2014 për aprovimin e listës së propozuar për shqyrtim nga Komisioni për Emërtimin e Rrugëve të Komunës së Gjakovës, për emërtimin e zonave të qarkullimit publik (rrugëve, parqeve dhe shesheve) në Komunën e Gjakovës

Me respekt,

Ljubomir Maric,
Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 16.12.2014
Br. 0204-1667

ZA: **Mimoza Kusari Lila**, Gradonačelnik Opštine Đakovica
Luan Gola Predsedavajući Skupštine Opštine Đakovica

PREDMET: Potvrda zakonitosti odluke 01 Br. 011-51211 od dana 27.11.2014 za usvajanje predloženog spiska za razmatranje od strane Komisije za Imenovanje Ulica Opštine Đakovice, za imenovanje zona javnog kretanja (ulica, parkova i trgova) u Opštini Đakovice

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene po zakonu za lokalnu samoupravu, kao i uredbe br.02/2011, o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva (prilog XII), nakon razmatranja odluke 01 BR. 011-51211 Dt. 27.11. 2014 usvojene od skupštine opštine Đakovica, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i ceni da je ista u skladu sa zakonom za lokalnu samoupravu.


Pravni akat koji proizvodi puni pravni efekat je kao sledeće:

- Odluka 01 Br. 011-51211 od dana 27.11.2014 za usvajanje predloženog spiska za razmatranje od strane Komisije za Imenovanje Ulica Opštine Đakovice, za imenovanje zona javnog kretanja (ulica, parkova i trgova) u Opštini Đakovice.

S'poštovanjem,

Ljubomir Maric,
Ministar Administracije Lokalne Samouprave

Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*
Rukovodiocima Odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 04-12-2014
Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- 47	204-167		

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____ /2014
Dt. 27.11.2014

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d dhe nenit 17 shkronja p e Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 14 shkronja o të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-071 për Sistemimin e Adresave, në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.11.2014, pas diskutimeve lidhur më pikën e VII-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i listës së propozimeve të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve të Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V e n d i m

- I. Aprovohet lista e propozuar për shqyrtim nga Komisioni për Emërtimin e Rrugëve të Komunës së Gjakovës, për emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik (Rrugëve, Parqeve dhe Shesheve) në Komunën e Gjakovës .
- II. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Lista me emrat e Zonave të Qarkullimit Publik (Rrugëve, Parqeve dhe Shesheve) në Komunën e Gjakovës, si dhe Lista me emrat rezervë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe të nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit .
- IV. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetares së Komunës,
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Agjencionit Kadastral të Kosovës
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Signature]
z. Luan Gola